



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KESHILLI I ANKESAVE

Nr. 115 prot.

Tiranë, më 11.08.2021

Lënda: Përcillet shkresa e Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive

**SHOQËRISË “TOP CHANNEL” SH.A.
PËR SUBJEKTIN AUDIOVIZIV PRIVAT “TOP CHANNEL”
Rruga “17 nëntori, nr.20, Kodër Mëzez, Kashar, Tiranë**

Bashkëlidhur ju dërgojmë shkresën e Këshillit të Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për shkelje të Kodit të Transmetimit në emisionin “Shqipëria live”.

Duke ju falënderuar,

SEKRETARI I PERGJITHSHEM

Vera Bushati



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KËSHILLI I ANKESAVE

Lënda : Tërheqje vëmendje për shkelje të rëndë të Kodit të Transmetimit

Drejtuar: **SHOQËRISË “TOP CHANNEL” SH.A.**
PËR SUBJEKTIN AUDIOVIZIV PRIVAT “TOP CHANNEL”
Rruga: “17 nëntori” Nr. 20, Kodër “Mëzez”, Kashar, Tiranë

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) kanë mbërritur disa ankesa, sipas të cilave, në emisionin “Shqipëria live”, të transmetuar në datën 4 Janar 2021 janë shkelur të drejtat dhe privatësia e fëmijëve gjatë transmetimit të intervistës së të miturit 14 – vjeçar, i cili flet nga banesa dhe nga vendi i krimit mbi vrasjen e nënës së tij.

Këshilli i Ankesave pranë AMA-s pasi shqyrtoi me kujdes materialin filmik, konstatoi shkelje të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive.

Konkretisht, intervistimi i të miturit në zbulim të plotë të identitetit të tij, që tregon detaje nga vendngjarja për vrasjen në të cilën ishte dëshmitar, cënon rëndë interesin e të miturit, dhe në këto kushte nuk duhej të transmetohej pasi rrezikohet zhvillimi moral dhe fizik i tij.

Në nenin 4 të Ligjit Nr.97/2013, “*Parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive. 1. Transmetimet audiovizive zhvillohen mbi bazën e këtyre parimeve*”: në pikën b sanksionohet se “*veprimtaria e transmetimeve audiovizive respekton paanshmërisht të drejtën për informacion, bindjet politike e besimet fetare, personalitetin, dinjitetin dhe të*

drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut. Kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”.

Nisur nga ky rast, Kodi i Transmetimit, sanksionon që;

“5.1 OSHMA-ve u ndalohet çdo raportim apo transmetim, që çon direkt apo indirekt në identifikimin me pamje dhe zë, me gjeneralitete, adresë apo përshkrues të çdo fëmije që mund të jetë ose është viktimë, dëshmitar, i hetuar, i akuzuar apo i deklaruar fajtor për kryerjen e një vepre penale, përveç rasteve me interes publik”.

“5.2 Duhet shmangur çdo raportim apo transmetim që çon direkt apo indirekt në identifikimin e çdo fëmije që mund të jetë ose është përfshirë në një ngjarje të rëndë familjare. Ndalohet intervistimi i fëmijës që mund të jetë përfshirë në një ngjarje të rëndë: p.sh, fëmijë të larguar nga familja, që kanë tentuar të vrasin veten, që janë përdorur nga grupe kriminale, që kanë qenë brenda një rrjeti prostitucioni, që i kanë prindërit të dënuar”.

Këshilli i Ankesave çmon se intervistimi i të miturit në kushtet kur ai rrëfen ngjarjen e rëndë kriminale, në vendin e ngjarjes, përbën shkelje të rëndë të Kodit të Transmetimit ndaj dhe nuk duhej të transmetohej. Ky transmetim, veç pasojave të tjera, mund të sjellë dëme serioze për shëndetin e të miturit në kushtet kur transmetimet audiovizive duhen të kenë prioritet interesin e fëmijëve.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mediave Audiovizive ju tërheq vëmendjen dhe kërkon ndalimin e çdo ritransmetimi të kësaj interviste, të respektoni Ligjin dhe Kodin e Transmetimit në përmbajtjet e ardhshme audiovizive si dhe të mbani parasysh interesin më të lartë të fëmijëve dhe të interesit publik. Përsëritja e një shkelje të ngjashme do përcillet për sanksion në Bordin e Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas parashikimeve ligjore.

Duke ju falënderuar,

PËR KËSHILLIN E ANKESAVE

Anëtarë: Erald Kapri
Irida Fështi

